



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Metoda Të Mësimdhënies Dhe Mendimi Kritik

Ngarkesa: 8 kredite; 90 orë mësimore; 60 leksione / 30 seminare

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti I / Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në “Mësuesi e Gjuhës Frënge për arsimin e mesëm të lartë”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Njohuritë

- Dallojnë metodat më kryesore të mësimdhënies.
- Klasifikojnë karakteristikat kryesore të metodave të mësimdhënies.
- Evidentojnë rezultatet e studimeve sipas përvojave të ndryshme.
- Zbatojnë modelet moderne të mësimdhënies në sistemin tonë arsimor.
- Gjykojnë në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese.
- Kuptojnë përkufizimin e të *menduarit kritik*, rëndësia dhe përkufizimi i termave
- Kuptojnë se si lidhet të menduarit kritik me logjikën, vërtetësinë apo pavërtetësinë e thënies, dijet dhe fuqizimin personal.
- Përdorimi i tij përmirëson aftësitë e të mësuarit të nxënësve dhe një kuptim dhe vizion më të mirë të fenomeneve komplekse.

Objektivat specifike lëndore:

Aftësitë dhe kompetencat

- të kërkojë aftësi më të larta të të menduarit si krahasimi, klasifikimi, prioritizimi, nxjerrja e përfundimeve, përcaktimi i marrëdhënieve tëshkakësi, të vlerësuarit
- përfshin aftësitë njohëse ose aftësitë e të menduarit,
- qëndrimi ose prirje në konceptimin e tij të të menduarit kritik
- kërkon një parashtrim të qartë të një problemi
- kërkon arsyei,
- kërkon të jesh i informuar mirë,
- kërkon të përdorësh dhe përmendësh burime të besueshme,
- përpjekjen për të marrë parasysh pamjen me të gjere,
- të qenit të ndjeshëm ndaj ndjenjave, nivelit të njohurive dhe shkallës së kompleksitetit.